




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KANAL 10
Arben Ahmeti
Drejtor
Prishtinë

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2022/25 - Valbon Bytyqi (Palë ankuese) kundër
Kanal 10 (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 5 korrik 2022 ka pranuar një ankesë nga Pala ankuese, e njëjta e parashtruar edhe tek Pala përgjegjëse me datën 7 korrik 2022, lidhur me pretendimin e transmetimit të lajmeve të pa vërteta në emisionin "InDoks", të Gazetës Online Insajderi, i transmetuar me datë 26 qershor 2022 në Kanal 10.
3. Në ankesën e parashtruar nga Pala ankuese theksohet se: *"Unë kërkoj nga ju, Kanal 10, të kërkonit falje dhe të korrigjoni lajmin e pa vërtetë të transmetuar nga minuta 43 – 45 në kuadër të emisionit InDoks lidhur me deklaratën shpifëse të Alban Pozhegut, që unë vazhdoj të punoj në Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe i koordinoj dhe menaxhoj auditimet në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore."*
4. KPM me datën 18 korrik 2022, me qëllim të sqarimit të pretendimeve ankimore të Palës ankuese, ka kërkuar nga Pala përgjegjëse që brenda tre (3) ditësh të sjellë sqarim lidhur me ankesën në fjalë.
5. KPM ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse, përmes të cilës ka theksuar se: *"mirëpret dhe garanton botimin e reagimeve të palëve, kurdo që ato vendosin që të i dërgojnë në adresë të redaksisë, por që pashmangshëm do t'i përfshijë edhe në pjesët në vazhdim që është duke i përgatitur për këtë histori."*
6. KPM me qëllim të vlerësimit të ankesës së Palës ankuese, në bazë të Raportit të monitorimit të datës 27 korrik 2022, ka gjetur se Pala përgjegjëse nuk e ka transmetuar reagimin e Palës

ankuese, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

7. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 10 gusht 2022 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për shkelje me të cilin ka kërkuar që në afat brenda shtatë (7) ditëve, nga pranimi i shkresës, Palës ankuese t'ia japë të drejtën për t'u përgjigjur lidhur me përmbajtjet e transmetuara për të cilat Pala ankuese i kundërshton si të pavërteta, siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
8. Për të vërtetuar se Pala përgjegjëse i ka ofruar të drejtën e reagimit Palës ankuese, KPM ka bërë sërish monitorim dhe bazuar në Raportin e monitorimit të datës 16 shtator 2022 ka gjetur se Pala përgjegjëse nuk e ka transmetuar reagimin e Palës ankuese, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Analiza ligjore

9. Komisioni i Pavarur i Mediave bazuar në faktet e lartpërmendura, ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 10 paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Nenin 10, paragrafi 1 i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

“Me qëllim korrektësisë dhe paanshmërisë duhet të ofrohet mundësia që brenda shtatë (7) ditësh pas paraqitjes së ankesës së individit apo organizatës, të transmetohet reagimi përkatës në mediumin e njëjtë. Reagimi duhet të transmetohet në kohë dhe hapësirë të njëjtë.”

10. KPM, me qëllim të vlerësimit të ankesës së Palës ankuese, në bazë të Raportit të monitorimit të datës 16 shtator 2022 ka gjetur se Pala përgjegjëse nuk e ka transmetuar reagimin e Palës ankuese, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 1 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
11. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se Pala përgjegjëse me mos transmetimin e reagimit të Palës ankuese, respektivisht mos dhënien e drejtës për reagim ka bërë shkelje të nenit 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Vendim


12. Pala përgjegjëse sanksionohet me gjobë në shumën prej një mijë (1.000) euro, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, pika 1.3, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

E drejta për ankesë

13. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet

me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

14. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Jeton Mehmeti
Kryetar



24.11.2023

Datë